



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-7461/17

Dt. 11.04.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Alban Xharra** nga Gjakova, për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+0, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesit: Alban Xharra nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual –shtëpi familjare, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban, Planin Detal Urbanistik “ Orize Lindore “ si dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-699, dt. 17.03.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 5094-35, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në pronësi të të lartëpërmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+0, me sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) të objektit **S=119.26 m²**.

Përdhesa: (Sip.Bruto): S= 119.26 m²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese “REAL projekt”-Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo Drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Alban Xharra nga Gjakova, me banim në rrugën "A.Buza", Nr 20, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-7461/17 të datës 04.04.2017 për dhënjën e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+0, në ngastrën kadastrale me nr. 5094-35, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, ", siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 28.01.2017, të vërtetuar nga DUMM.
2. Kopjen e planit të datës 30.03.2017 në pronësi të Alban (Agim) Xharra nga Gjakova të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me nr.të lëndës 1370/17, të datës 13.03.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/01-699, të datës 17.03.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastren kadastrale me nr. 5094-35, ZK: Gjakovë – J- Qytet të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320/01-7063, dt.31.03.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-H-86 të datës 18.01.2017.
7. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 27.03.2017.
8. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.Gjakovë, të datës 24.03.2017.
9. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë.
10. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Posten e Kosoves, filiala Gjakovë me datë 17.03.2017.
11. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja projektuese "REAL Projekt" -Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 570.90 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi,pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspekcionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike



Zenel Shabani.jur.dipl.

U.D.Drejtori


Elida Bejtullahu, inxhe dipl.e ark.

K. GJAKOVË
Z.K. : Gj. j. Qytet
Ng. nr. 5094-35

PLAN SITUACIONI



Gjendja faktike
Gjendja kadastrale

PRONARI: ALBAN XHARRA
DIMEN. 10 X 12
ETAZHITETI: PERDHESE
S = 120m²

Gjakovë,
09.03.2017

Punoi: Fatmir Bobi tek.

Kontrolloi: Durrije Berisha I.D.A.

[Signature]

[Signature]

P = 1 : 500

Vërtetoi : N.P.SH."GELI"
DREJTORI

28.01.2017
GPS
Auto CAD 2004

Punoi : *Thelal F. Zhubi, insh.dipl.i gjed.*


Frrok Hajdaraj

KOPJE PLANI

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Prone

Zona kad. Gjakove Jashte Qytet
Poseduesi: 1 /1 Xharra Alban (Agim)

Shk. zvog. 1: 500




Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtje
					Ha	a	m ²	
5094-35		-	arë	4	0	03	00	
Gjithësejt					0	03	00	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë, 18.01.2017



VERIETON: *Arben Jusufi*

[Signature]